



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT
SEKTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr 1020 Prot.

Tiranë, më 18 / 05 / 2026

Lënda: Mbi raportin e monitorimit për 4 mujorin e parë të 2026

MINISTRISË SË FINANCIVE
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3
Tiranë

Bazuar në ligjin nr.55/2023 "Për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer", ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2026", udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore", si dhe shkresës të dërguar "Mbi raportin e monitorimit të 4-mujorit 2026" datë 06.05.2026 është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Agjencinë e Menaxhimit të Garancisë dhe Kredive të Pakthyer për 4- mujorin e parë të vitit 2026.

1. Hyrje

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer (AMGKP), është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për financat, i krijuar sipas Ligjit nr. 55/2023, "Për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer", i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2024.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2026 për AMGKP-në përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e AMGKP-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen e objektivave të synuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të institucionit

në krahasim me planin e miratuar. Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientim dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Ky raport do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës institucioni do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë të institucionit.

2. Informacioni buxhetor

Me anë të shkresës nr. 18540/6 prot., datë 23.01.2026 e administruar në AMGKP me nr. 159 prot., datë 26.01.2026, është dërguar miratimi i detajimit të shpenzimeve korrente për vitin 2026.

Në lekë

E.Q	M.L	Kod inst	Emërtim Institucioni	Kap	Kod.Pro g.	Llog ekonomike	Kod thesari	Kod produkti	Emertimi i Produkti	Debiti
001	10	1010324	Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	01	01120	6000000	3535	91002AE	Kontrata të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	47,369,100
001	10	1010324	Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	01	01120	6010000	3535	91002AE	Kontrata të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	7,000,000
001	10	1010324	Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	01	01120	6020000	3535	91002AE	Kontrata të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	17,000,000
002	10	1010324	Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	01	01120	6060000	3535	91002AE	Kontrata të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	
001	10	1010324	Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	01	01120	2310000	3535	91002AE	Kontrata të Garancive dhe Kredive të Pakthyer	
			Total							71,369,100

Artikulli 600 për paga është miratuar në shumën 47,369,100 lekë, artikulli 601 për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është miratuar në shumën 7,000,000 lekë dhe artikulli 602 për mallra dhe shërbime është miratuar në shumën 17,000,000 lekë.

Me anë të shkresës nr. 18540/7 datë 23.01.2026 “Mbi miratimin e detajimit të limitit mujor për vitin 2026” për artikullin 600+601 për 4- mujorin e parë janë miratuar 26,433,000 lekë, ndërsa për artikullin 602+606 për 4-mujorin e parë janë miratuar 12,500,000 lekë.

Gjatë 4-mujorit të viti 2026, këto burime financiare AMGKP i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligj.

AMGKP ka një produkt me emërtim “Kontrata të Garancive dhe Kredive të Pakthyer”.

Në vijim paraqiten, në mënyrë të përmbledhur, treguesit e realizimit të fondeve buxhetore për këtë periudhë, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

Tabela 1: Raporti përmbledhës i shpenzimeve*Në lekë*

Emërtimi	Buxheti vjetor (Plani)	Buxheti 4-mujor (Plani)	Realizimi 4-Mujor (Fakti)	Realizimi në %
Shpenzime Korente	71,369,100	38,933,000	18,942,650	48.65
Shpenzime Kapitale	0	0	0	0
Totali	71,369,100	38,933,000	18,942,650	48.65

Shpenzimet korente janë planifikuar për 4 mujorin e parë në shumën 38,933,000 lekë dhe janë realizuar në masën 48.65 %.

Për vitin 2026 nuk janë miratuar shpenzime kapitale.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për këtë periudhë, për AMGKP-në paraqitet si në vijim:

Tabela 2: Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë*Në lekë*

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor (Plani)	Buxheti 4-mujor (Plani)	Realizimi 4-mujor (Fakti)	Realizimi në %
600+601	Paga dhe Sigurime	54,369,100	26,433,000	16,562,948	62.66
602+606	Shpenzime për mallra,shërbime dhe shpërblime	17,000,000	12,500,000	2,379,702	19.03
231	Shpenzime kapitale	0	0	0	
	TOTALI	71,369,100	38,933,000	18,942,650	81.69

Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”, buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2026 për këtë zë është 54,369,100 lekë, buxhet i cili do të mbulojë nevojat e institucionit në fushën e pagave për të gjithë vitin, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Buxheti i detajuar në shpenzime personeli për periudhën janar-prill 2026, është 26,433,000 lekë. Realizimi paraqitet në vlerën 16,562,948 lekë ose 62.66 % të planit 4 mujor.

Për sa i përket numrit të punonjësve me urdhërin nr.17 datë 25.01.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë”, numri i punonjësve të AMGKP-së do të jetë gjithësej 30 veta. Gjithashtu me VKM Nr.10, datë 15.01.2026, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026, në njësitë e qeverisjes qendrore”, për institucionin tonë janë miratuar 4 punonjës me kontratë 6 orë.

Mesatarja e plan/faktit për numrin e punonjësve janë 31 persona nga 34 persona gjithësej bashkë me punonjësit me kontratë 6-orar.

Artikulli 602+606, "Shpenzime për mallra, shërbime të tjera dhe shpërblime", buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull për vitin 2026, është 17,000,000 lekë

Artikulli 602+606 për shpenzime mallra dhe shërbime nga 12,500,000 lekë që është planifikuar për 4 mujorin e parë është realizuar në masën 19.03 %. Kjo përqindje pritet të rritet të 4 – mujorin e ardhshëm. Shpenzimet për artikullin 602 kanë qënë shpenzimet për institucionin si shpenzime për shërbime postare, energji elektrike, shpenzime të tjera transporti, ujë, telefon fiks, taksa bashkie,gjoba, qiramarrje, udhëtim i brendshëm, shpenzime përmbare, ASHK,shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, sigurim dhe ruajtje dhe shpenzime kompensim telefon Drejtor i Përgjithshëm.

Shpenzime e artikullit 602+606 të detajuara si më poshtë vijon:

Në lekë

Artikulli 602+606	Realizimi 4- mujor
Shpenzime shërbime postare	20,480
Shpenzime energji elektrike	116,249
Shpenzime të tjera transporti	235,320
Shpenzime ujë	10,992
Shpenzime telefoni fiks	12,000
Shpenzime taksa bashkie, gjoba	16,727
Shpenzime qiramarrje	1,120,000
Shpenzime udhëtim i brendshëm	422,140
Shpenzime përmbare, ASHK	266,900
Shpenzime sigurimi dhe ruajtje	27,694
Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit	115,200
Shpenzim kompensim telefoni Dr i Përgjithshëm	16,000
TOTAL	2,379,702

Me shkresën nr. 495 Prot., datë 02.03.2026 është miratuar transferim fondi nga artikulli 602 në artikullin 606 në vlerën 48,000 lekë për kompensimin e telefonit të Drejtorit të Përgjithshëm, duke qënë se artikulli 606 për vitin 2026 është miratuar në vlerën 0.

Për 4- mujorin e parë referuar regjistrin të parashikimeve të vitit 2026, i cili përmban zërat e mëposhtëm: sigurim të pasurisë të objektit dhe pajisjeve, mirëmbajtje e automjeteve (lavazh), shërbime të printimit/fotokopjimit/skanimit/shërbim mirëmbajtje, materiale pastrimi, shërbim mirëmbajtje pajisje elektronike dhe zyrave, kancelari + tonera, shërbime për automjete/pjesë këmbimi, shpenzime për automjete/goma, shërbime për automjete/vaj filtra, hartim plan evakuimi blerje fikse zjarri etj, shpenzime siguracioni për tre makinat në përdorim, blerje karburanti, janë realizuar 4 procedura me vlerë të vogël si më poshtë:

1. Pagesë për ruajtjen e automjeteve të sekuestruara të debitorëve.
2. Mirëmbajtje e automjeteve (lavazh).
3. Shërbime të printimit/fotokopjimit/skanimit/shërbim mirëmbajtje.
4. Shpenzime për automjete, goma.

Nërkohë që janë në proces si më poshtë:

1. Blerje karburanti (naftë për automjete të institucionit).
2. Shërbime për automjete, vaj filtra, etj.

Arkëtimet nga debitorët:

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, një ndër objektivat e saj ka dhe mbledhjen e kredive të ish bankave të nivelit të dytë me kapital shtetëror dhe investimet në banesa nga INSIG sh.a.

Sipas shkresës nr 23022/1 prot. datë 14.02.2024 mbi operimin e llogarive bankare të arkëtimit të detyrimeve të huamarrësit, llogaritë ekzistuese në monedhat lekë, euro, usd në emër të kësaj agjencie do të operojnë sipas praktikës të deritanishme për arkëtimet e debitorëve të krijuar para datës 31.12.2023.

Referuar ligjit nr.55/2023, Kreut II, neni 3, pika 2 e ligjit citon “Të ardhurat e përfituara sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 4 dhe nenit 15 të këtij ligji, derdhen në buxhetin e shtetit. Të gjitha arkëtimet e debitorëve dhe gjendja e mbetur e llogarive bankare është bërë derdhje në buxhetin e shtetit për KFW-në. Janë mbajtur vetëm komisionet mujore për mirëmbajtjen e llogarive dhe komisionet e transfertave drejt TSA për çdo llogari.

Plani për mbledhjen e arkëtimeve për vitin 2026 për debitorët e transferuar nga ish-bankat me kapital shtetëror dhe Insig është vendosur në shumën 50,000,000 lekë. Ndërsa plani për 4 – mujorin e parë të vitit 2026 është 15,834,000 lekë.

Plani është realizuar në masën 65.56 %.

3. Performanca jo-financiare e programit buxhetor

Misioni i AMGKP-së është: *Sigurimin e menaxhimit të skemave të veçanta të garancive të huasë dhe trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr.55/2023, “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”.*

Përshkrimi i Produktit: *“Mbledhja e detyrimeve të huamarrësve kundrejt Ministrisë së Financave si rezultat i pagesës së garancive dhe detyrimeve të Ish bankave me kapital shtetëror”.*

Qëllimi Politikës së Programit: *“Menaxhimi e skemave të veçanta të Garancive të huasë, mbledhjen e detyrimeve të kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre”.*

Objektivat e Agjencisë:

- Mbledh detyrimet e huamarrësve kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat për detyrimet që kanë lindur si rezultat i pagesës së garancive nga ministria përgjegjëse për financat dhe si rezultat i marrëdhënies së huadhënies e nënhuazimit të fondeve;
- Verifikon dhe konfirmon përmbushjen e kërkesave të marrëveshjeve të garancisë në tipat e kontratave bankare;
- Administron informacionin dhe dokumentacionin e skemave të veçanta të garancisë;
- Monitoron shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj ministrisë përgjegjëse për financat për pagesat e kryera nga kjo e fundit, në kuadër të marrëveshjeve të garancisë;
- Kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci nga skemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje.
- Mban, menaxhon dhe përditëson bazën e të dhënave dhe regjistrin analitik të garancive që menaxhon.

Tregues i performancës i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me objektivat janë:

1. *“Numri i debitorëve të trajtuar duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total të detyrimeve”*
2. *“Numri i kredive të mbyllura në raport me numrin e kredive në trajtim”.*
3. *“Numri i çështjeve të trajtuara për thirrjen e Garancisë si dhe trajtimi i nënhuave”.*
4. *“Përqindja e uljes të portofolit në trajtim”.*

Sipas raportimit të Sektorëve të AMGKP-së, do të gjeni treguesit e performancës dhe detyrat e realizuara për të arritur objektivat kryesore të institucionit.

• Sektori i Ndjekjes së Procedurave Juridike dhe Operacionale

Objektivat e planifikuara në Sektorin e Ndjekjes së Procedurave Juridike dhe Operacionale për muajt Janar-Prill:

Gjatë periudhës raportuese, sektori ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me objektivat e përcaktuara në planin 4-mujor, i cili është realizuar në nivelin 65.56% planit të arkëtimit. Fokusi i punës ka qenë trajtimi i dosjeve të debitorëve, ndjekja e procedurave ligjore dhe administrative, si dhe përmirësimin e performancës së realizimit të detyrave institucionale.

Treguesit e arkëtimeve dhe performances:

Stafi është orientuar edhe për një vëmendje të posaçme kushtuar etapave të trajtimit ligjor të huamarrësve.

Gjatë periudhës Janar – Prill 2026

1. Janë verifikuar për konfirmimin e të dhënave të debitorëve 424 dosje debitorësh aktual.
2. Janë ndjekur 47 seanca gjyqësore.
3. Janë përgatitur 7 deklarata mbrojtje, rekurse, konkluzione përfundimtare, plotësim të metash padie.
4. Është bërë 1 aplikim në ASHK, dhe 2 Urdhër-pagesa.
5. Janë kryer 31 shërbime në terren.
6. Janë përgatitur 22 kthim përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme.
7. Janë përgatitur 22 praktika lirim barre hipotekore dhe 18 praktika pushim veprimesh Përmbartimore.

Realizimi i të ardhurave nga arkëtimet e detyrimeve të debitorëve për periudhën Janar – Prill 2026 është si më poshtë:

Progresiv Janar –Prill 2026

Plan	Fakt	%
15,834,000 All	10,380,250 All	65.56

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së AMGKP-së janë hasur problematika, të cilat kanë çuar në mos realizimin e planit si:

- *Kufizimi i lëvizjeve në terren.*
- *Pavlefshmëria e titujve ekzekutivë.*
- *Amortizimi i borxhit.*
- *Adresat jo të sakta.*
- *Mosha e debitorëve.*
- *Kushtet e vështira social-ekonomike të debitorëve.*
- *Mungesa e dokumentacionit tekniko-ligjor të pasurive në pronësi të AMGKP-së.*
- *Mungesa e regjistrimit në QKB.*
- *Mungesa e të dhënave të debitorëve.*
- *Numri në rritje i procesve gjyqësore.*

Punët e realizuara sipas objektivave:

1. Trajtimi dhe verifikimi i dosjeve të debitorëve.
2. Është vijuar puna për verifikimin dhe përpunimin e dosjeve të debitorëve.
3. Puna në terren dhe kontaktet me debitorët.
4. Janë realizuar shërbime në terren me qëllim verifikimin e gjendjes së debitorëve për ndjekjen e detyrimeve, si dhe për pjesëmarrjen në seanca gjyqësore.
5. Procedurat ligjore dhe gjyqësore.
6. Sektori ka ndjekur në menyrë të vazhdueshme proceset gjyqësore.
7. Procedurat administrative dhe bashkëpunimi institucional.
8. Janë trajtuar kërkesa të ndryshme të debitorëve dhe procedura të ndryshme.

Përmbyllja e rasteve:

Gjatë periudhës raportuese janë mbyllur 16 raste debitorësh, si rezultat i ndjekjes dhe trajtimit të vazhdueshëm të tyre.

Pritshmëritë që ka sektori për periudhën e mbetur të vitit 2026:

Në vijim të strategjisë, në kuadër të realizimit të planit janë programuar këto detyra:

1. Intensifikimin e punës në terren në kontaktin me debitorin, trajtimin dhe realizimin e planit të arkëtimeve.
2. Grupimin, klasifikimin dhe analizën e portofolit të debitorëve sipas ndarjes territoriale, vlerës së detyrimit, kolateralit dhe statusit ligjor të tyre.

• Sektori i Ndekjes së Procedurave të Ekzekutimit Permbarimor

Gjatë 4-mujorit të parë Janar-Prill 2026 janë ndjekur dhe kryer detyra dhe programe nga juristët e Sektorit për të arritur qëllimet dhe objektivat, të cilat ky sektor kërkon, duke filluar me evidentimin e informacioneve nga zyra permbarimore si private dhe ato shtetërore, plotësimin e database me të dhënat mbi dosjet me palë kreditore AMGKP-në si dhe ndjekjen shkresore të rasteve të veçanta.

Për më tepër janë zhvilluar detyrat e shpjeguara më specifikisht si më poshtë vijon:

1. Janë punuar dhe dorëzuar 16 urdhër-pagesa mbi tarifatat për shpenzimet permbarimore, shpenzime për çelje trashëgimie, për caktim përfaqësuesi ligjor të debitorëve etj.
2. Janë punuar dhe dorëzuar 33 informacione drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm si dhe Drejtorit të Drejtorisë mbi shkresat hyrëse për veprim të mëtejshëm nga ana e sektorit.
3. I jemi drejtuar në formë shkresore me 27 shkresa tek Zyrat Permbarimore, si dhe dërgim informacioni ose kërkesa për veprim sipas rasteve specifike, gjithashtu edhe institucioneve të tjera si Gjendja Civile për informacione të nevojshme të sektorit.

Gjatë periudhës 4–muajore sektori ka mbajtur dhe ka ndjekur evidencën operative të fazave të trajtimit ligjor për të gjithë debitorët, duke e pasqyruar këtë informacion në Excel ku është kryer azhurnimi dhe punimi i 255 shkresave të ardhura nga Zyrat Përmbare.

1. Është bërë kontrolli dhe punimi i 891 dosjeve të zonave të ndryshme të Shqipërisë dhe të dhënat janë të pasqyruara në Excel çdo muaj.
2. Janë dërguar tek të gjitha Zyrat Përmbare Shtetërore dhe Private, përkatësisht 47 shkresa me lëndën “Kërkesë për Informacion” dhe nga 17 prej tyre kemi marrë informacion, të cilin e kemi përgatitur në Excel specifikisht për secilën zyrë.
3. Eshtë dërguar 1 rast UE origjinale Garanci Sovrane për ekzekutim pranë Zyrës Përmbare.
4. Janë kryer takime me Zyra Përmbare si vijon, ZP Tiranë, Durrës, Laç, Kukës, për të cilat është kryer raportim pas çdo shërbimi.

• Sektori i Verifikimit të Kërkesave të Garancisë dhe Konfirmimit të Kontratave

Objektivat:

1. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve të huamarrjes së institucioneve financiare në zbatim të skemave të veçanta të garancive, të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe të emetuara nga Ministria përgjegjëse për financat.
2. Trajtimi dhe shqyrtimi rast pas rasti i kërkesave të huadhënësve mbi thirrjen e Garancisë, sipas skemave të veçanta të saj, duke verifikuar plotësimin e kushteve për thirrjen e Garancisë, sipas legjislacionit në fuqi. Aktualisht po trajtohen rastet e Garancise Sovrane Nr.1 dhe Nr.2 sipas rastit janë kryer pagesat e garancive dhe do të vazhdojmë të ndjekim rikuperimin e tyre si dhe thirrjet e rasteve për pagesë në vazhdim.
3. Konfirmimi i draftit të marrëveshjes së huasë, si dhe verifikimin e përmbushjes së kërkesave të marrëveshjeve të garancisë në tipat e kontratave bankare dhe konfirmimin e këtyre kontratave tip brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga paraqitja e kërkesës nga institucioni financiar, përkatësisht për Garancinë Sovrane Nr.5.
4. Mbajtja në mbikqyerje e rasteve të Garancisë Sovrane Nr.4.
5. Ndjekja dhe trajtimi i marrëveshjeve të nënhuave, huave buxhetore dhe kredive të garantuara, si dhe rakordimi me Ministrinë e Financave mbi pagesat e kryera dhe shumën e detyrimeve të mbetura, brenda datës 15 të çdo muaji, në formë elektronike.

Detyrat e realizuara dhe treguesit e performances:

1. Janë trajtuar rastet për të cilat është kryer pagesa e garancisë nga Ministria e Financave me miratimin e Agjencisë dhe është kërkuar informacion shkresërisht Bankave lidhur me veprimet e kryera për rikuperimin e detyrimit.
2. Janë trajtuar dhe ndjekur marrëveshjet e nënhuave dhe huave buxhetore të marrë në dorëzim nga Ministria e Financave, si dhe brenda datës 15 të çdo muaji është rakorduar me Ministrinë e Financave mbi pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimin e mbetur, në përputhje me Udhëzimin nr. 21087 datë 16.11.2023 të Ministrit të Financave.

3. Janë kryer takime me subjektet kredimarrës si Bashkia Korçë, Bashkia Durrës, Bashkia Berat, Bashkia Fier, Bashkia Kavajë, Bashkia Elbasan dhe Bashkia Peshkopi, në të cilat është diskutuar mundësia e shlyerjes së detyrimeve ndaj Ministrisë së Financave.
4. Është ndjekur ecuria e skemës së Garancisë Sovrane Nr. 5, ku kanë aplikuar 21 subjekte, për të cilat është shqyrtuar gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bankat.
5. Është zhvilluar takim me ABI Bank, ku është marrë me procesverbal dorëzimi subjekti “Shoesery” shpk për rikuperimin e detyrimit dhe i është kaluar sektorit të Proedurave të Ekzekutimit Përmbarrimor për tu vënë në ekzekutim.
6. Është trajtuar rasti i subjektit “Mito by Caterina Firenze ” shpk ku pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të marrëveshjes është kryer pagesa nga Ministria.
7. Është trajtuar rasti i subjektit “Danish Green Garden” shpk ku pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të marrëveshjes është kryer pagesa nga Ministria.
8. Është trajtuar rasti i subjektit “Emanuel Gas ” shpk ku pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të marrëveshjes është kryer pagesa nga Ministria.
9. Janë dërguar kërkesa për informacion mbi gjendjen e llogarive bankare me qëllimin verifikimin e aftësisë paguese të huamarrësve, bankave të nivelit të dytë për subjektet Kesh dhe UKT.
10. Është trajtuar rasti i subjektit “Sauli” shpk ku pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të marrëveshjes është bërë kërkesa për pagesë Ministrisë.
11. Janë dërguar “Njoftime për shlyerje detyrimi” të gjithë subjekteve huamarrës për të cilët është kryer pagesa e garancisë nga Ministria e Financave.
12. Është rikuperuar shuma prej 2,800,000.00 lekësh në buxhetin e shtetit për subjektin “Diamond Society” shpk, për të cilin është paguar garancia.

Gjatë periudhës Janar – Prill 2026 janë mbledhur dhe derdhur në buxhetin e shtetit, totali i detyrimeve si më poshtë:

Për nënhatë dhe hatë buxhetore:

28,266,383.23 AED

260,729.71 SDR

7,736,814.93 ALL

9,007,207.47 EUR

Për kreditë e garantuara:

57,192.04 EUR

- **Sektori i Informacionit dhe Administrimit te Dokumentacionit**

Objektivat:

1. Administrimin e dokumentacionit të skemave të veçanta të garancive shtetërore, arkivimin dhe përditësimin e të dhënave të garancive.
2. Aplikime në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për nxjerrje çertifikate pronësie, kartel pasurie, hartë treguese etj.
3. Kontrollin dhe inventarin e pronave në pronësi të Agjencisë.
4. Raportimin periodik në Bankën e Shqipërisë mbi debitorët e mbyllur.
5. Përgatitjen e dosjeve të veçanta për çdo objekt të marrë në pronësi nga AMGKP dhe ndjek me përgjegjësi të gjitha procedurat për dokumentimin, administrimin dhe shitjen në ankand të këtyre pasurive sipas përcaktimeve në Ligjin e AMGKP-së dhe akteve nënligjore në fuqi.

Treguesit e performancës:

1. Janë raportuar mbylljet në Bankën e Shqipërisë për 10 debitorë.
2. Nuk ka patur procedura për ankand, pasi pritët të miratohet Rregullorja për procedurat.
3. Janë nxjerrë 4 çertifikata të reja, kontabilizuar 2 prona të reja si dhe dërguar 32 shkresa ASHK-së.
4. Janë administruar të gjitha shkresat në server si dhe 20 dosje te reja te GS 5 .

Administrimi i faqes zyrtare të web- it të AMGKP-së, duke përfshirë azhornimin e Programit të Transparencës dhe hedhjen e njoftimeve të ndryshme.

Puna e realizuar sipas objektivave përkatëse:

1. Administrimi i dosjeve të skemave të garancive, realizuar 100%.
2. Raportimi në Bankën e Shqipërisë, realizuar 100%.
3. Administrimi i faqes zyrtare si dhe azhornimi i Programit të Transparencës 100%.
4. Bashkëpunimi me ASHK-në në lidhje me problematikën e pronave 20%.
5. Ankandet, realizuar 0%.

- **Sektori i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të Vecanta të Garancisë**

Puna e kryer Janar-Prill 2026 nga sektori për të arritur objektivat:

1. Përpunuar informacionin e ardhur nga bankat e nivelit të dytë lidhur me Garancitë Sovrane 1,2,3,4 dhe 5.
2. Përgatitur brenda afateve raporti i garancive çdo muaj për Ministrinë e Financave.
3. Analizuar statement dhe dokumentacioni ekonomik-ligjor në bashkëpunim me sektorin e Verifikimit dhe Konfirmimit të Kontratave për 4 subjekte, për të cilat është thirrur Garancia, në mënyrë që të vërtetohet që e gjithë shuma e disbursuar është

- përdorur për qëllimin e garancisë sipas marrëveshjeve përkatëse, si nëse ka mangësi në dokumentacion.
4. Përgatitur brenda afatit parashikimi i flukseve të principalit për buletin për 3 muajor (Janar-Mars 2026), për vitin 2032 dhe dërguar Ministrisë.
 5. Përgatitur informacion Ministrisë sa herë është kërkuar lidhur me principalet që plotësojnë kushtin për pagesë .
 6. Rakorduar çdo muaj me Ministrinë e Financave për pagesat e kryera të garancinë për subjektet.
 7. Rakorduar me Ministrinë e Financave çdo muaj për pagesat e kthyera mbrapsht nga subjektet të cilëve u kemi paguar garancinë.
 8. Rakorduar çdo muaj me Ministrinë e Financave për detyrimin e mbetur të subjekteve ndaj Ministrisë së Financave.
 9. Shqyrtuar të gjitha aplikimet e ardhura për Garancinë Sovrane 5 (GS5).
 10. Mbajtja e evidencës për çdo aplikim të ardhur për GS5.
 11. Krijuar database me të dhënat sipas bankave për skedulet e kredive të GS5 për 10 subjekte të cilat janë disbursuar pas aplikimit të kryer.

Objektivat e Sektorit të Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të Veçanta të Garancisë:

1. Kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci nga skemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrje.
2. Mban, menaxhon dhe përditëson bazën e të dhënave dhe regjistrin analitik të garancive që menaxhon.
3. Verifikimin e aftësisë paguese të subjekteve huamarrëse për të cilat është kryer pagesa e garancisë në secilën prej skemave të garancive të miratuara, huave dhe nën-huave, të garantuara nga Ministri përgjegjës për financat.
4. Shqyrton dhe analizon raportet periodike të çdo huadhënësi për huatë e aprovuara prej tij dhe çdo informacion dhe dokument tjetër të nevojshëm për monitorimin e ecurisë së garancisë.

Treguesit e performancës :

1. Sektori çdo muaj merr raportet nga bankat e nivelit të dytë të cilat janë pjesë e Skemave të Garancive Sovrane 1,2,3,4 dhe 5. Pas marrjes së raporteve përpunon të dhënat dhe konfirmon bankën për saktësinë ose jo të raportit.
2. Evidenton çdo muaj totalin e principaleve të cilat janë të vonuara në pagesë nga subjektet sipas skemave dhe sipas marrëveshjeve të lidhura.
3. Evidenton principalet e vonuara të cilat e kanë plotësuar kushtin për tu paguar garancia për secilën bankë.
4. Verifikohen disbursimet për çdo subjekt nëse nuk kanë kaluar limitin sipas kontratës së kryer.
5. Verifikohen dhe monitorohen overdraftet nëse stoku nuk ka kaluar disbursimin sipas kushteve të kontratës së lidhur.
6. Përpunohen të dhënat për nxjerrjen e stokut, principalit të paguar dhe principalit progresiv.
7. Përpunohet çdo skedulim kredie i ardhur nga banka lidhur me pagesat e subjekteve.

8. Monitorohen bankat dhe verifikohet çdo raport lidhur me pagesat e kryera per Garancinë nga Ministria e Financave si dhe përlllogaritja e tyre si pagesë për subjektin.
9. Evidentohen dhe verifikohen të gjitha kreditë apo overdraftet të cilat janë raportuar nga banka si të mbyllura.
10. Përgatiten raporte 3,6,9 dhe 1 vjeçare për Ministrinë dhe parashikohet çdo 3 muaj fluksi i principaleve deri në 2032 dhe gjithashtu parashikimi i stokut për kuadrin makro një ose dy herë në vit deri në vitin 2032.
11. Monitorohet dhe përpunohet çdo skedul kredie i ri i ardhur nga Garancia Sovrane 5.
12. Monitorohen shumat e marra të kredisë në GS5 si dhe nëse është tejkalar limiti.
13. Përpunohet dhe përgatitet çdo lloj raportimi që kërkohet nga Ministria e Financave sipas nevojës.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Arëni Lleshanaku

